

KLAUZOLAT E ARBITRAZHIT TË ICC-SË

Rekomandohet që, palët të cilat dëshirojnë t'i referohen arbitrazhit të ICC-së në kontratat e tyre, të përdorin klauzolën standarde të mëposhtme.

Klauzola Standarde e Arbitrazhit të ICC-së

Të gjitha mosmarrëveshjet që lindin nga ose në lidhje me këtë kontratë, do të zgjidhen përfundimisht sipas Rregullave të Arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, nga një ose më shumë arbitra të caktuar në përputhje me këto Rregulla.

Palët janë të lira ta përshtatin klauzolën sipas rrethanave të tyre të veçanta. Për shembull, duke pasur parasysh që Rregullat e Arbitrazhit të ICC-së parashikojnë caktimin e një arbitri të vetëm, palët mund të duan të përcaktojnë numrin e arbitrave. Gjithashtu, ato mund të dëshirojnë të përcaktojnë vendin dhe gjuhën e arbitrazhit, si dhe ligjin e zbatueshëm për themelin e çështjes. Rregullat e Arbitrazhit të ICC-së nuk e kufizojnë lirinë e palëve për të zgjedhur vendin dhe gjuhën e arbitrazhit ose ligjin rregullues të kontratës.

Gjatë përshtatjes së klauzolës, duhet pasur kujdes që të shmanget çdo paqartësi e mundshme. Formulimi i paqartë i klauzolës do të shkaktojë pasiguri dhe vonesë, si dhe mund të pengojë, madje edhe të kompromentojë procesin e zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Gjithashtu, palët duhet të kenë parasysh faktorët që mund të ndikojnë në zbatimin e klauzolës sipas ligjit të zbatueshëm. Këta faktorë përfshijnë çdo kërkesë të detyrueshme që mund të ekzistojë në vendin e arbitrazhit dhe në vendin apo vendet në të cilat pritet ekzekutimi.

Arbitrazhi i ICC-së pa Arbitrin e Emergjencës

Nëse palët dëshirojnë që Dispozitat për Arbitrin e Emergjencës të mos zbatohen, ato duhet ta përcaktojnë shprehimisht këtë duke i shtuar klauzolës së mësipërme fjalinë që vijon:

Dispozitat për Arbitrin e Emergjencës nuk zbatohen.

KLAUZOLAT E ARBITRAZHIT TË ICC-SË

Klauzola Standarde e Arbitrazhit të ICC-së pa Publikimin e Vendimeve

Të gjitha mosmarrëveshjet që lindin nga ose në lidhje me këtë kontratë, do të zgjidhen përfundimisht sipas Rregullave të Arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, nga një ose më shumë arbitra të caktuar në përputhje me këto Rregulla. Nuk lejohet publikimi i asnjë vendimi apo urdhri procedural të dhënë gjatë procesit të arbitrazhit.

Arbitrazhi i Përsheptuar

Rregullat e Arbitrazhit të ICC-së parashikojnë një procedurë të përsheptuar për çështjet me vlerë më të ulët. Nëse palët duan që Dispozitat për Procedurë të Përsheptuar të mos zbatohen, ato duhet ta përcaktojnë shprehimisht këtë duke i shtuar klauzolës së mësipërme fjalinë që vijon:

Dispozitat për Procedurë të Përsheptuar nuk zbatohen.

Palët që dëshirojnë të përdorin procedurën e përsheptuar në çështje me vlerë më të lartë, duhet ta përcaktojnë shprehimisht këtë, duke i shtuar klauzolës së mësipërme fjalinë që vijon:

Bazuar në nenin 30(2)(b) të Rregullave të Arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, palët bien dakord që Rregullat për Procedurë të Përsheptuar zbatohen pavarësisht vlerës së mosmarrëveshjes.

Nëse palët duan të përcaktojnë një vlerë tavan për zbatimin e Rregullave për Procedurë të Përsheptuar, që është më e lartë se sa përcaktohet në këto Rregulla, atëherë duhet t'i shtojnë klauzolës së mësipërme fjalinë si më poshtë:

Bazuar në nenin 30(2)(b) të Rregullave të Arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, palët bien dakord që Rregullat për Procedurë të Përsheptuar zbatohen, me kusht që vlera e mosmarrëveshjes të jetë nën [përcakto shumën] dollarë amerikanë në momentin e njoftimit të referuar në nenin 1(3) të Rregullave për Procedurë të Përsheptuar.

Klauzolat me Hapa

Arbitrazhi i ICC-së mund të përdoret si forumi përfundimtar për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, nëse përpjekjet e mëparshme të palëve për të zgjidhur mosmarrëveshjen me mjete të tjera, si ndërmjetësimi, kanë dështuar. Palët që dëshirojnë të përfshijnë në kontratat e tyre klauzolën me hapa për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, që kombinon arbitrazhin dhe ndërmjetësimin e ICC-së, duhet t'u referohen klauzolave standarde të Rregullave të Ndërmjetësimi të ICC-së.

Ekzistojnë edhe kombinime të tjera shërbimesh. Për shembull, arbitrazhi mund të përdoret si alternative ndaj ekspertizës ose bordeve të mosmarrëveshjeve. Gjithashtu, palët që i drejtohen arbitrazhit të ICC-së mund të dëshirojnë të përdorin shërbimet e Qendrës Ndërkombëtare të ICC-së për ADR lidhur me propozimin e një eksperti, nëse gjatë procesit të arbitrazhit kërkohet vlerësimi i ekspertit.

Klauzola standarde për këtë dhe kombinime të tjera shërbimesh gjenden në disa gjuhë në faqen e internetit **<https://iccwbo.org/dispute-resolution-services/>**.